



Pranuar / Dorezuar Prilipsoni/Protokolo Received/Delivered	28.04.2021	1	viti god Year
Organ / Shërbimi Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	2046/2021		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.151/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.151/2021 të datës 18.03.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Rruga e Prishtinës” pa numër në Gjilan, kundër Vendimit me Nr. Prot:8744 të datës 25.11.2020 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “largim nga shërbimi civil”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.151/2021 të datës 18.03.2021, të parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi** Vendimi me Nr. Prot:8744 i datës 25.11.2020 i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
- III.** Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetarit të Kolegjit.

**A r s y e t i m**

Ndaj ankuesit punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në pozitën “Zyrtar për Licencim”, më datë 11.11.2020 është bërë fletëparaqitje për në Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Drejtori i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës kishte themeluar një komision për kontrollimin e lëndëve të cilat ishin të përfunduar por licencat nuk kanë qenë të tërhequra, Komisioni në përbërje të plotë me datë 05.11.2020 ka bërë kontrollin dhe ka kolauduar se mungojnë pesë (5) licenca të pa tërhequra.

Pas konstatimit të komisionit për mungesën e licencave ku përshkruhet se citoj “*në dollapin për ruajtjen e lëndëve me licenca të pa tërhequra munguan 5 licenca, lëndë fizike të këtyre subjekteve afariste: 1. Fer Petrol Import të D+B; 2. Fer Petrol shitje me pakicë D+B Komoran; 3. Fer Pertol shitje me pakicë D+B Terstenik; 4. Borovci Petrol shitje me pakicë D+B Kmetovc Gjilan dhe 5. Ori Petrol shitje me pakicë D+B Pozhoran. Me insistimin tonë kontaktuam zyrtarin në fjalë dhe e pyetëm ku janë lëndët ai u deklaruar se lëndët i ka te shpija me vete. Në mungesë të lëndëve subjekteve nuk ju kanë dhënë licencat. Për mos tërheqjen e licencave drejtori ka njoftuar inspektoratin i cili ka intervenuar te këto subjekte dhe në mungesë të licencave ju ka shqiptuar dënimet*”

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, më datë 25.11.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot: 8744 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”.

Në bazë të dëshmimeve të lëndës, Arkiva e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë më datë 25.11.2020 ankuesit i ka përcjell Vendim me Nr. Prot: 8744 e Komisionit Disiplinor, ndërsa ankuesi edhe pse nga data 25.11.2020 nuk është në marrëdhënie punë në MTI më datë 04.03.2021 ka parashtruar kërkesë me arsyetim që: “*...vendimin nuk e kam pranuar në formë fizike apo me postë, andaj me mirësjellje lusë që me ipet vendimi dhe të vazhdoje procedura të mëtejshme*”.

Ankuesi kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, më datë 18.03.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1227/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.03.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë më datë 26.03.2021 ka dërguar provat e kërkuara.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 1227/2021 e datës 18.03.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:8744 të datës 25.11.2020 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; Kërkesën e datës 04.03.2021 të ankuesit; Vendimin e datës 05.11.2020 të Komunës së Gjilanit; Akt Emërimit e datës 19.09.2019 të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës “Zyrtar për Licencim”; Fletëparaqitjen e datës 11.11.2020 për Komisionin Disiplinor; E-mailin e datës 05.11.2020 të E-mailat e datës 05.11.2020 nga ankuesi; E-mailat e datës 10.11.2020 nga ankuesi; Procesverbal i datës 11.11.2020; E-mailin e datës 25.11.2020 nga ARKIVA MTI për ankuesin; Ftesë për Komision Disiplinor e datës 19.11.2020 për ankuesin; E-mailin e datës 19.11.2020 të ankuesit; Procesverbalin e datës 19.11.2020, 23.11.2020, 25.11.2020, 16.11.2020 të Komisionit Disiplinor; Auditimi me kërkesë i datës 19.11.2020; E-mailin e datës 25.11.2020 nga Mesazhet në telefon 07.11.2020; E-mailin e datës 23.11.2020 dhe 21.08.2020 nga Lista e licencave të pa tërhequra datës 10.06.2020,19.12.2019, 21.02.2020, 21.08.2020, 24.09.2020, 13.10.2020; Njoftimi i datës 23.11.2020; E-maili i datës 09.11.2020 nga Raporti i prezencës në punës për periudhën 18.05.2020-16.11.2020 për ankuesin; Raporti i IKSHPI i datës 09.11.2020; E-maili i datës 04.11.2020 nga ankuesi; Udhëzim i Mjekut Specialist; E-maili i datës 12.10.2020 nga ankuesi; E-mailin e datës 21.07.2020 nga ankuesi; E-mailin e datës 18.06.2020 nga E-mailin e datës 11.06.2020; Kërkesë për pushim datë 07.09.2020, 24.08.2020, 12.06.2020; E-mailin e datës 11.09.2020 nga ankuesi; Shkresë për procedurë të licencimit nga dhe Përgjigje në ankesë e datës 26.03.2021 nga MTI.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ është e pabazuar, **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Komisioni Disiplinor ka bërë vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike.

Kolegji, ka shqyrtuar pretendimin e parë fillimisht se ankuesi nuk ka qenë i informuar lidhur me fillimin e procedurës disiplinore, ky pretendim është i pa qëndrueshëm, sepse ankuesi me datë 19.11.2020 është ftuar në seancë të komisionit disiplinore, i njëjti me imell të datës 19.11.2020 ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkak të gjendjes shëndetësore, prandaj komisioni disiplinor duke pranuar kërkesën e ankuesit ka shtyrë seancën për datë 23.11.2021. Ankuesi nga komunikimet në imella e ka pasur të qartë në mënyrë të plotë sepse është ftuar në komision disiplinor, gjithashtu ankuesi pretendon që nuk jam njoftuar që unë mund të kem mbrojtës profesional, nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi ka kërkuar që në seancë të këtë shoqërues dhe të mos jete lejuar nga ana e komisionit disiplinor, gjithashtu Kolegji konstaton se mbrojtësi në procedurë administrative nuk është i obliguar sipas ligjit, prandaj kjo rrethanë nuk mund të këtë ndikuar në zhvillimin e procedurës ndaj ankuesit!

Lidhur me pretendimin e ankuesit se lëndët nuk i kam pasur në shtëpi dhe imellave i është dhënë kuptim jo i duhur nga ana e komisionit disiplinor, Kolegji konstaton se bazuar në raportin e komisionit që ka kontrolluar lëndët është e pa kontestueshme se lëndët kanë munguar në zyrën ku është dashur me qenë, ndërsa në bazë të imellave të datës: 05.11.2020 ankuesi \_\_\_\_\_ pran në mënyrë të qartë dhe direktet citoj “*po tani ato subjekte janë aty ora 13 me i marr pagesat ka mundësi që mungojnë sepsr cam pas probleme personale me ta dhe këtë kam pas me zgjedh këto dite mes meje dhe atyre, nuk ka të keqe asgjë vetëm se unë ju kam detyruar ne borgj atyre subjekteve dhe nuk kam muajt me javë kthye se marrëveshja ka qenë me javë kthye të hollat në momentin që ju bëhen licencat, por unë nuk kam pasur mundësi me javë kthye”, gjithashtu në imallin e datës: 10.11.2020 ankuesi shkruan citoj “ Të nderuar, tash ndërkohë i bjen lëndët një person. Ja kam dhënë nr e juaj ju kontakton”. Gjithashtu ka si dëshmi në lëndë edhe komunikime me sms në mesë të ankuesit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të tij ku shihet qartë që ankuesi lëndët i kishte marr në shtëpi.*

Kolegji, konstaton se, bazuar në provat e lëndës, ankuesi nuk ka mund të dëshmoj se lëndët e subjekteve afariste kanë qenë në zyrën apo tavolinën e tij, përkundër në bazë të komunikimeve të lartcekura vërtetohet edhe nga vet ankuesi që lëndët nuk kanë qenë brenda zyrës respektivisht ka deklaruar që i ka me vete, po kështu ankuesi edhe në seancë të Komisionit Disiplinor në pyetjet e anëtarëve të komisionit ankuesi ka pohuar se të gjitha komunikimet me email janë të tijat dhe autentike, ndërsa gjatë mbajtjes së takimit të komisionit disiplinor ankuesi ka pohuar se lëndës i ka dorëzuar dhëndri im pasi që unë kam qenë në spital në atë kohë ia ka dorëzuar \_\_\_\_\_ kurse në pyetjani e kryetares së komisionit disiplinor znj. \_\_\_\_\_ se: “*e dhëndri juaj çka ka sjellë që e përmende më herët?*”, ankuesi është përgjigjet “*Jo, Jo, dhëndri im e ka sjell një fletëpagesë*”, në ndërkohë ankuesi ka pohuar se kur unë kam thënë kështu që i sjell lëndët dikush e kam pas fjalën tek Agimi, edhe ky deklaram i ankuesit në seancë tregon që ankuesi nuk ka qenë i sinqertë në përgjigjet e tije, sepse bie ndesh më komunikimet përmes imellave zyrtare që i ka bërë me mbikëqyrësin e drejtpërdrejt dhe drejtorin e DRRRTN.

Bazuar në faktin që ankuesi dokumentet zyrtare të subjekteve afariste që kanë aplikuar për licencë i përdor jashtë vendit të tij të punës, po ashtu i njëjti nuk ka komunikuar me udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë ose me kolegët e zyrës por pranon që lëndët i ka sjell një person që nuk është as punëtor i ministrisë, po ashtu marrë parasysh faktin që ankuesi me deklaramet e tij ka pohuar se me disa prej subjekteve afariste si Borovci dhe Arin janë shokë të shtëpisë, ndërsa deklaroi se kompania Fer i ka

ndihmuar për shkak të halleve që ka pasur me qëllim që në momentin që bëhet lënda duhet me i ndihmuar kështu e kemi pasur marrëveshjen, po ashtu ankuesi ka deklaruar në seancë të komisionit disiplinor se këtyre kompanive ju ka marr borgje me kusht që kur të na bëhet licenca me naj kthye se duhet me shkuar me paguar licencën, tregon pa asnjë dyshim që ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.

Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës dhe deklaratimet e ankuesit në seancë të Komisionit Disiplinor, ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut siç parashihet me nenin 25 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***“1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforsimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”***, po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, ***zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.***

Duke ju referuar provave të lëndës dhe vetë deklaratimeve të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesit ka bërë shkeljeve të rënda të detyrave të punës të përcaktuar me nenin 46 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke bërë një varg shkeljesh si: mos përmbushja e detyrave të punës, mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda, moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës, shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil dhe shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi, Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, bazuar në kompetencat e tij të përcaktuara me legjislacionin në fuqi respektivisht me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ka bërë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura dhe ka përcaktuar dhe shqiptuar masën disiplinore.

Bazuar në të gjitha rrethanat Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore “largim nga shërbimi civil” e shqiptuar ndaj ankuesit nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me Vendimin me Nr. Prot:8744 të datës 25.11.2020 është në proporcion me shkeljen e bërë nga ankuesi, rrjedhimisht komisioni disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4, nenin 48 paragrafin 3, nenin 50 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, mbi bazë të kësaj Vendimi me Nr. Prot:8744 i datës 25.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është në përputhje me nenin

47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në këtë edhe pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRTËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.151/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

